Udhëzues për zbatimin e politikës DA-PO-005 ““Politika për përdorimin e logos, simbolit të akreditimit dhe referencës në akreditim”, rishikimi 11, datë 17.10.2025

Zbatuesit: Organet e akredituara nga DPA**, s**tafi i DPA-së dhe vlerësuesit teknik, grupet teknike të punës

Përgjegjësi për zbatim: Menaxheri cilësisë

Kontrolloi: Menaxheri i Cilësisë

Ardita MELE

Miratoi: Drejtori i Përgjithshëm

Pranvera FAGU

1. **Qëllimi**

   Ky dokument jep udhëzime në lidhje me zbatimin e politikës DA-PO-005 "Politika për përdorimin e logos, simbolit të akreditimit dhe referencës në akreditim", rishikimi 11 datë 17.10.2025.

2. **Fusha e zbatimit**

   Ky dokument zbatohet vetëm për qëllime të zbatimit të politikës DA-PO-005, rishikimi 11 datë 17.10.2025. Dokumenti përcakton afatet për një tranzicion të suksesshëm për OVK-të në lidhje me ndryshimin e simbolit të akreditimit dhe përdorimit të markës EA MLA. Ky dokument do të jetë i vlefshëm deri në përfundim të periudhës tranzitore të përcaktuar në politikën DA-PO-005.

3. **Përgjegjësitë**

   Është përgjegjësi e organeve të akredituara, stafit të DPA, vlerësuesve teknik, ekspertëve teknik të zbatojnë këtë dokument. Menaxheri i cilësisë është përgjegjës për zbatimin e këtij udhëzimi.

4. **Simboli i akreditimit**

Bazuar në politikën DA-PO-005, simboli i akreditimit përmban logon e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, veprimtarinë e vleresimit te konformitetit, standardin kundrejt të cilit është akredituar dhe numrin e akreditimit. Numri i akreditimit është numri i certifikatës së akreditimit dhe përbëhet nga shkurtimi i vlerësimit të konformitetit dhe numri rendor.

Për qëllime të zbatimit të politikës DA-PO-005, rishikimi 11, datë 17.10.2025, Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit do t'i dërgojë të gjitha organeve të akredituara prej saj, simbolin e ri të akreditimit brenda datës 20 Dhjetor 2025. Numri i certifikatës së akreditimit për secilin nga organet e vlerësimit të konformitetit mbetet i pandryshuar.

Organet e akredituara nga DPA duhet të fillojnë të përdorin simbolin e ri të akreditimit që pas marrjes së tij nga DPA në certifikatat/raportet e lëshuara prej tyre. Gjatë periudhës tranzitore, në treg dhe në media do të ekzistojnë certifikata/raporte dhe materiale publicitare me prezencën e të dy simboleve të akreditimit. Në fund të periudhës tranzitore, OVK –të duhet të sigurojnë vetëm përdorimin e simbolit të ri të akreditimit në dokumenta, materiale promovuese dhe faqet e websitit.

Është përgjegjësi e organeve të vlerësimit të konformitetit të sigurojnë heqjen dhe tërheqjen e të gjitha dokumentave në formë të shkruar apo elektronike ku shfaqet simboli i vjetër i akreditimit, qofshin këto edhe dokumenta të klientëve të tyre. Gjithashtu, organet e vlerësimit të konformitetit (OVK) duhet

të njoftojnë DPA-në për heqjen e simbolit të vjetër nga të gjitha dokumentet e tyre dhe ato të klientëve të tyre, brenda periudhës kalimtare.

Të gjitha organet e akredituara që kanë nënshkruar marrëveshjen e licencës për përdorimin e kombinuar të markës ILAC MRA ose përdorimin e kombinuar të markës IAF MLA, duhet të përdorin markat në kombinim me simbolin e ri menjëherë pas marrjes së simbolit të ri të akreditimit. Brenda datës 30 Dhjetor 2025, këto organe janë të detyruara të depozitojnë në DPA një shembull të markës së kombinuar në mënyrë që DPA të verifikojë saktësinë dhe mënyrën e dukjes së saj.

5. Përdorimi i markës EA MLA

Bazuar në politikën DA-PO-005, organet e akredituara nga DPA mund të përdorin markën EA MLA në raportet dhe certifikatat për aktivitetet për të cilat DPA është nënshkruese e EA MLA. OVK-të e akredituara që dëshirojnë të përdorin markën EA MLA duhet të bëjnë një kërkesë me shkrim në DPA. Organet që bëjnë kërkesë mund të fillojnë ta përdorin markën EA MLA vetëm pas marrjes së miratimit nga DPA dhe marrjes së markës nga ana e DPA. Marka EA MLA nuk mund të shoqërohet me simbolin e vjetër të akreditimit.

6. Certifikatat e akreditimit

DPA do të rishikojë certifikatat e akreditimit të të gjithë organeve të vlerësimit të konformitetit. Brenda datës 20 Dhjetor 2025, certifikatat e reja të akreditimit do të jenë të publikuara në faqen e websitit të DPA. Në momentin e marrjes së certifikatës së re të akreditimit, OVK-ja duhet të dorëzojë certifikatën origjinale ekzistuese. OVK e akredituara duhet të marrin masa për heqjen nga tregu/media të certifikatave të vjetra të akreditimit brenda datës 28 Shkurt 2026.

7. Vlerësimi nga DPA

Për organet e vlerësimit të konformitetit të akredituara nga DPA, deri në përfundim të periudhës kalimtare, gjatë vizitave mbikëqyrëse ose zgjeruese ose jashtërradhe, grupet e vlerësimit të DPA duhet t'i rikujtojnë organeve të vlerësimit të komformitetit datën e përfundimit të afatit për tranzicionin e simbolit të akreditimit (17.10.2026). Me përfundimin e këtij afati, cdo shmangie nga politika DA-PO-005 do të trajtohet sipas procedurës DA-PM-004.

Për organet të cilat janë akredituar pas datës së miratimit të politikës DA-PO-005, rishikimi 11, zbatimi i kërkesave të kësaj politike fillon në ditën e dhënies së akreditimit.

Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në mënyrë të vazhdueshme do të publikojë në faqen e saj të websitit informacion në lidhje me zbatimin e politikës DA-PO-005.